



Alberto  
Buckaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1346 / Prot.  
13

Vlorë më, 27.09. 2022

VENDIM  
Nr. 37, datë 27.09.2022

PËR  
MIRATIM E GJUHËS SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT TË DYFISHTË TË  
STUDIMIT, MASTER SHKENCOR NË "PROJEKTIM DHE MENAXHIM I  
SISTEMEVE TURISTIKE DHE KULTURORE".

Në mbështetje të nenit 38, nenit 71 "Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë", nenit 75 "Programet e ciklit të dytë të studimeve", të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Universitetit të Vlorës dhe Universitetit të Barit "Aldo Moro", si dhe referuar propozimit të Departamentit të Biznesit ardhur me shkresën nr.1338 prot, datë 23.09.2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27.09.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë për miratim e gjuhës së zhvillimit të programit të dyfishtë të studimit, Master Shkencor në "Projektim dhe menaxhim i sistemeve turistike dhe kulturore", sipas shkresës nr.1338 prot, datë 23.09.2022.
2. Gjuha e zhvillimit të programit do të jetë në shqip dhe italisht.
3. Një kopje e këtij vendimi i përcillet MAS.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. ROLAND ZISI

